REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 09, datë 23.10.2025

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "KAPANON INDUSTRIAL 1-2 KAT", ME VENDNDODHJE NË QEREKË, BASHKIA KRUJË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit", i ndryshuar, me propozim të subjektit Z. Sami Xhixha, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Kapanon industrial 1-2 kat", me vendndodhje në Qerekë, Bashkia Krujë, me zhvillues z. Sami Xhixha.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
   a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
   b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Krujë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

ENEA KARAKAÇI

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 06/07/ 2026